

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

A F A Sh.p.k

Sot me date 05.01.2026, palet e meposhtme:

z. Artan Bashli, lindur ne Shkoder

Ka vendosur te nenshkruaje Statutin e meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe nga ky Statut.

KAPITULLI I

FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1 – Forma

1.1 Shoqeria **“A F A” Sh.p.k.** (ne vijim “Shoqeria”) krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij Statuti.

1.2 Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

1.3 Statuti eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emertimi

Emertimi i Shoqerise eshte **“A F A” Sh.p.k.**

Neni 3 – Objekti i shoqerise

3.1 Shoqeria ka per objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

3.1 Ne menyre me specifike, Shoqeria do te kryeje aktivitet tregtar:

- Projektim dhe zbatim dhe zbatim i veprave ndertimore si vijon: ndertime me karakter civil dhe ekonomik, punime, germime dhe sistemime dheu, tarracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndertime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndertime terrenesh, etj.

Neni 4 - Selia

4.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen Lagjja Kongresi i Permetit, Bulevardi Bujar Bishanaku, Zona Kadastrale nr. 8591, Nr pasurise 7/793, kati 1, Shkoder, 4001

4.2. Transferimi i selise se Shoqerise ne nje vend tjeter behet me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

4.3. Asambleja e Ortakeve mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.



Neni 5 – Kohezgjatja e veprimtarise

5.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 Lek (njqind mije) i perbere nga 1 (nje) ortak me 1 (nje) kuote.

Neni 7 - Kontributet

7.1 Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:

-Ortaku **Artan Bashli** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 100.000 Lek (njqind mije)

7.2 Sipas kontributeve te mesiperme:

-Ortaku **Artan Bashli** i perket 1 (nje) kuote, qe i korrespondon me 100% (njqind per qind) te kapitalit te Shoqerise.

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Ortakeve.

8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Ne rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 9 – Zvogelimi i kapitalit themeltar


9.1 Shoqeria mund të zvogelojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese se Ortakeve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogelohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

9.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shperblim ashtu edhe pa shperblim në kuptimin me të gjere të fjales, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjera të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet me pare t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjera.



10.3 Ne nje rast te tille ortaku qe do te transferoje kuoten e tij duhet te njoftoje ortaket e tjere, me leter rekomande me kthim pergjigje, mbi synimin per shitje, duke percaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e bleresit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet te gjitha kuotave te ofruar per shitje.

10.4 Ortaket do te kene ne dispozicion 15 (pesembedhete) dite nga marrja e letres rekomande, per t'i komunikuar ortakut qe transferon kuotat, synimin e tyre per te ushtruar apo jo te drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes.

10.5 Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht, me vendimin pozitiv te Asamblese se Ortakeve.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 – Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendim-marres i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

11.2 Asambleja e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per çeshtjet vijuese: ndryshimet e statutit, emerimi e shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel e likuidatoreve, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqerise, miratimi i bilancit dhe per çdo vendim tjeter parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni perkates.

Neni 12 – E drejta e pjesemarrjes dhe e votes

12.1 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i kuotave qe ai zoteron.

12.1 Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjeter jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se ciles mund te jape voten e tij.


12.3 Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kapitalit qe zoteron, ne qofte se voton personalisht per pjesen e mbetur.

Neni 13 – Thirrja e Asamblese se Ortakeve, Kuorumi dhe Vendimet

13.1 Asambleja e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilancit, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabel sidhe inventarit.

13.2 Asambleja mund te thirret ne çdo moment nga nje prej Administratoreve si edhe prej nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit themeltar. Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje qe duhet t'u dergohet ortakeve – ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve – dhe ekspertit kontabel (nese eshte emeruar), te pakten 15 (pesembedhete) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblese, mbi çeshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.

13.3 Asambleja mund te thirret edhe jashte selise se Shoqerise.



13.4 Ne rast se Asambleja e Ortakeve nuk mblidhet me thirjen e pare per mungesen e kuorumit te parashikuar ne piken 13.7 te ketij Statuti, Asambleja e Ortakeve do te thirret brenda 30 (tridhjetë) ditesh me te njejtin rend dite.

13.5 Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjithë pjesemarresit te mund te identifikohen dhe t'u lejohet atyre te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te çështjeve ne rend te dites; pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari ne te cilin duhet te ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.

13.7 Vendimet e Asamblese se Ortakeve, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% (tridhjetë perqind) te kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese se Ortakeve qe kerkojne nje shumice te cilesuar, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne te pakten 51% (pesedhjetë e nje perqind) te kapitalit themeltar.

13.8 Asambleja e Ortakeve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, me voten pro te $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e ortakeve te pranishem qe zoterojne te pakten 51% (pesedhjetë e nje perqind) te kapitalit themeltar. Ne te gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakeve merr vendime me shumice te thjeshte votash te ortakeve qe zoterojne me shume se 30% (tridhjetë perqind) te kapitalit themeltar.

13.9 Cdo Asamble drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjetër i caktuar nga vete Asambleja. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emeron nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo-ortak.

13.10 Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

14.1 Shoqeria administrohet nga te pakten 1 (nje) Administrator i cili do te qendroje ne detyre deri ne shkarkim apo doreheqje ose per nje periudhe prej 5 (pese) vitesh.

14.2 Perfaqesimi ligjor i Shoqerise me palet e treta i besohet Administratorit. Administratori mund te ushtroj fuqite konform me sa parashikohet ne nenin 95 te Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 "Per tregtare dhe Shoqerite tregtare".

14.3 Me kete akt emerohet 1 (nje) Administrator i Shoqerise personi si me poshte:

z. Artan Bashli, lindur ne Shkoder,

14.4 Administratoret mund te emerojne perfaqesues te posaçem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.

Neni 15 – Eksperti kontabel i autorizuar

15.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakeve, kontrolli i balanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet nje ose disa eksperteve kontabel te autorizuar.

15.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.



KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit
- 16.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejt vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicen e kerkuar nga Ligji n. 9901 te dates 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.
- 17.2 Asambleja mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqeria priset me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.
- 18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, vdekjes, ose falimentimit te ortakeve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.
- 19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.



19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.

19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve

20.1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte ndermjet paleve te interesuara.

20.2 Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarreveshjes, ato do t'i besohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 21 – Gjuha

21.1 Ky Statut eshte hartuar ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe .

ORTAKU I SHOQERISE

Artan Bashli

Artan Bashli

